



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.07.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:43 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *z. Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Brikena Ukperaj*).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Sipas njoftimit të bërë dhe krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme, datë 26.07.2023, ora 14:30.

Sipas një rendi dite të përditësuar kemi dy çështje për të trajtuar. Pika e parë shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, për të cilin është përgatitur edhe relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Gjithashtu kemi edhe një pikë të dytë, shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, për të cilin janë përgatitur relacionet përkatëse nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Siç e përmenda ky rend është i përditësuar.

Për më tej vazhdojmë me pikën 1 të saj, duke ia dhënë fjalën relatores zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka për detyrim që të përcaktojë gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale.

Me vendimin e djeshëm nr. 466, datë 25.07.2023, Këshilli ka caktuar gjykatat dhe gjyqtarët udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magjistratë, për vitin akademik 2023-2024, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për katërmujorin e parë (korrik – tetor 2023), të dytë (nëntor 2023-shkurt 2024) dhe katërmujorin e tretë (mars 2024 – qershor 2024).

Pas miratimit nga Këshilli të vendimit të mësipërm, sot në datën 26.07.2023 është paraqitur një kërkesë nga kandidatja për gjyqtare znj. {...}, e cila ka parashtruar disa rrethana të reja të cilat sipas kandidates e bëjnë të pamundur kryerjen prej saj të praktikës profesionale në Tiranë pasi ndodhet në situatë emergjente për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtje të lëshuar për të dhe 3 fëmijët e saj të moshës 13, 8 dhe 4 vjeç. Nga dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, i cili në mënyrë të detajuar nuk përmendet në relacion dhe nuk po e relatoj për shkak edhe të të dhënave sensitive dhe karakterit privat, personal të këtyre të dhënave por i gjeni në vendimet të cilat janë bashkëlidhur relacionit, ka rezultuar se më datë 05.07.2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje për paditësen kandidaten për gjyqtare znj. {...} dhe tre fëmijët e saj të mitur duke u urdhëruar bashkëshorti i kandidates, që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë dhune në familje ndaj paditëses dhe tre fëmijëve, së bashku me një sërë masash të tjera mbrojtëse, midis të cilave edhe detyrimi i të paditurit, bashkëshorti i kandidates që të largohet nga banesa ku ata jetojnë në qytetin e Fierit e të mos i afrohet kandidates dhe fëmijëve përtej një distance prej 100 m. (Për më tepër referojuni arsyetimit të vendimit të lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes).

Ndërkohë rezulton që më pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes të jetë bërë edhe

vërtetimi i këtij urdhri me vendimin nr. 125, datë 12.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, duke u caktuar të njëjtat masa mbrojtëse sikurse kishte edhe nxjerrja e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Në kushtet e mësipërme kandidatja ka kërkuar që të ndryshohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku ajo do të kryejë praktikën profesionale për çështjet penale e civile, pasi nuk ka asnjë njeri tjetër për t'u kujdesur për fëmijët e saj.

Komisioni pasi shqyrtoi kërkesën dhe provat, vlerëson se për shkak të rrethanave të reja të ndodhura rishtazi, për të cilat Këshilli vihet në dijeni sot pas miratimit të vendimit nr. 466, datë 25.07.2023, është e nevojshme të ndryshohet gjykata dhe gjyqtarët udhëheqës ku kandidatja për gjyqtare znj. {...} do të kryejë praktikën profesionale për katërmujorin e parë korrik–tetor 2023 dhe katërmujorin e dytë nëntor 2023–shkurt 2024, duke caktuar respektivisht për katërmujorin e parë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier si gjykatën ku ajo do të kryejë praktikën profesionale për çështjet penale si dhe për katërmujorin e dytë Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, si gjykatën ku ajo do të kryejë praktikën profesionale për çështjet civile.

Të dyja gjykatat e mësipërme plotësojnë kriterin ligjor lidhur me madhësinë dhe infrastrukturën, me qëllim krijimin e kushteve sa më optimale për zhvillimin e praktikës profesionale dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë kandidatët për të kryer praktikën profesionale në mënyrë sa më cilësore, në drejtim të natyrës dhe sasisë së çështjeve që shqyrtohen në këto gjykatat, referuar juridiksionit dhe madhësisë së tyre. Ndërsa lidhur me numrin e mjaftueshëm të gjyqtarëve udhëheqës, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier janë vetëm dy gjyqtarë në listën e miratuar nga Këshilli që janë pjesë e seksionit penal (pasi kjo gjykatë i të ndarë gjyqtarët në seksione), ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk ka ende ndarje të seksioneve midis gjyqtarëve, por ka dy gjyqtarë udhëheqës të miratuar nga Këshilli në listën e përditësuar të tyre.

Lidhur me gjyqtarët udhëheqës pranë të cilëve kandidatja do të kryejë praktikën

profesionale, duke qenë se në Fier ku ajo ka vendbanimin është e pamundur që të caktohet për të kryer praktikën për çështjet civile sepse gjyqtarët mentorë janë vetëm gjyqtarët penalistë, Komisioni ka vlerësuar që për katërmujorin e parë praktika për çështjet penale të kryhet në qytetin e Fierit duke u caktuar gjyqtare udhëheqëse znj. {...}, pra pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ndërkohë që për katërmujorin e dytë, duke qenë se në listën e mentorëve nuk kemi gjyqtarë civilistë në këtë gjykatë, kemi propozuar Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, pranë gjyqtares udhëheqëse znj. {...}.

Për sa më sipër, në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 466, datë 25.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar veç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, edhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si gjykata që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili gjyqtar, viti akademik 2023–2024.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet ndryshimi pjesërisht i listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë, viti akademik 2023–2024, duke caktuar për kandidaten për magistratë znj. {...}, si gjyqtar udhëheqës znj. {...} në sesionin e parë katërmujor korrik 2023 – tetor 2023 dhe znj. {...} në sesionin e dytë katërmujor nëntor 2023 – shkurt 2024.

Së fundmi, parashikohet momenti i hyrjes në fuqi menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, referuar parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Faleminderit! Ky është relacioni i projektvendimit të paraqitur për shqyrtim sot në rrethanat emergjente sikundër u bënë të ditura edhe në e-mail-in e dërguar anëtarëve. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për sa u parashtrua.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Rusi: Zoti Toro!

Alban Toro: Dakord.

Ilir Rusi: Zonja Shehu!

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 466, datë 25.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar veç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, edhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si gjykata që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2023–2024.

2. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023–2024, duke caktuar për kandidaten për magjistrate znj. {...}, si gjyqtar udhëheqës znj. {...} në sesionin e parë katërmujor korrik 2023 – tetor 2023 dhe znj. {...} në sesionin e dytë katërmujor nëntor 2023 – shkurt 2024.

3. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.07.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:43 dhe mbaroi në orën 15:03.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Alban Toro | (anëtar) |
| 6. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 7. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 3. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e dytë e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, për të cilën është janë përgatitur relacionet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Kurushi i cili parashtron relacionin e përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**, e cila ka paraqitur një kërkesë për caktimin e një gjyqtari në një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t’i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga {...} dhe {...}. Gjyqtarët z. {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr.20, datë 22.05.2023, me të cilin është pranuar kërkesa për rishikimin e këtij vendimi.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçante të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar të përzgjidhet me short 1 (një) i tillë nga 4 (katër) gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, seksioni penal, të cilët u shortuan dje sipas kërkesave për caktim gjyqtari të kërkuar sërish nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesë me nr. 129), gjyqtare Migena Laska.

Parashtrohet relacioni i përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** e cila ka paraqitur dy kërkesa për caktimin e një gjyqtari në dy çështje penale që ndodhen në seancën e fazës paraprake (lexohen të dhënat e çështjes që do t’i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion. Në çështjen e parë gjyqtari {...}, i caktuar sipas

vendimit datë 06.07.2023 të Këshillit, ka paraqitur kërkesë për heqje dorë, e cila i është pranuar, pasi ka dhënë vendimin datë 17.05.2023 në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Gjyqtarja {...} ka pasur në gjykim në seancë paraprake këtë çështje penale, por me vendimin e datës 07.12.2022 ajo ka dhënë dorëheqjen pasi është kthyer gjyqtare e çështjes së themelit për të gjykuar të pandehurin tjetër në një procedim të lidhur me atë për të cilën po kërkohet gjyqtari në seancë paraprake. Kjo dosje është e ndarë nga dosja ku aktualisht kërkohet të gjykohet shtetasi {...} në seancë paraprake. Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurve {...} etj. Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim themeli çështjen nr. 71, në ngarkim të të pandehurve {...}, {...} etj; (gjykim tjetër i ndarë, por i lidhur me çështjen që kërkohet sot caktim gjyqtari)

Gjyqtarja {...} ka dhënë vendimin nr. 88/2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë për të pandehurit {...}, {...} etj; Ndërsa gjyqtarja {...} ka dhënë vendimin nr.302/2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të {...} etj.

Çështja e dytë që referohet në tabelë – Gjyqtari {...} ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë një çështje penale e cila është në një procedim të lidhur me atë që sot po kërkohet caktim gjyqtari. Gjyqtarja {...} ka pasur në gjykim në seancë paraprake çështjen penale me të pandehurit {...} etj., dhe ajo ka dhënë dorëheqjen pasi është kthyer gjyqtare e çështjes së themelit. Ndërsa gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për shkaqet e përmendura më lart, që janë të njëjta, kanë kryer veprime si në fazën e hetimit paraprak ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor të themelit.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1(një), sepse: Për çështjet me numër rendor nr. 1 dhe nr. 2 në tabelë, duke qenë se është i njëjti procedim penal dhe kërkohet plotësimi i trupit gjykues për seancat paraprake respektive, në pajtim me parashikimin K.Pr.Penale, përkatësisht Nr.332/1 ku për përcaktohet se: “Kërkesat për dërgimin për gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”, do të caktohet një gjyqtar për 2 kërkesat përkatëse.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër. Bashkëlidhur gjendet edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë të gjitha kriteret ligjore të përmendura më lart për të shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga kjo gjykatë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjet nr. 1 dhe nr. 2, penale (kërkesat nr. 2063 dhe nr. 2064), gjyqtari Paulin Çera.

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor